



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 44 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, në Rekomandim të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit me nr.prot.02-052/09-0085963/23 të datës 06.12.2023, nxjerr këtë;

V E N D I M **PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E SPORTISTËVE TË** **DALLUAR PËR VITIN 2023 NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

Neni 1

Për përzgjedhjen e sportistëve të dalluar të vitit 2023 në Komunën e Podujevës, ngritët komisioni në këtë përbërje:

1. **Ismet Haliti,** kryesues
2. **Vehbi Kastrati,** anëtar
3. **Merita Azemi - Sadriu,** anëtare
4. **Gazmend Ahmeti,** anëtar
5. **Blerina Fejzullahu - Kika,** anëtare

Neni 2

Komisioni bënë vlerësimin e propozimeve / nominimeve të Klubeve Sportive dhe në bazë të sukseseve dhe rezultateve të arritura në gara vendore dhe ndërkombëtare, bënë përzgjedhjen e sportistëve të dalluar për vitin 2023 në Komunën e Podujevës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i'u dërgohet:
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS
Anëtarëve të komisionit, përmes DKRS-së
QSHQ/Arkivit

Nr.Prot. 02-020/04-0086131/23
Podujevë, datë: 06.12.2023


Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 3 parag.3, 8 dhe 27 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, Vendimin nr.prot.01-400/03-0084071/22, të datës 29.09.2022, për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe Parashikimet Buxhetore 2024-2025, sipas Thirrjes publike nr. prot.09-016/01-0073208/23 datë 05.10.2023, në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot. 02-200/04-0079807/23 të datës 01 nëntor 2023, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, merr:

VE N D I M

Neni 1

Për financimin e projekteve individuale, për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës, sipas Thirrjes publike dt. 05.10.2023, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **3,600.00 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve kulturore dhe artistike dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë marrëveshje/kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/04-0286391/23
Podujevë, date: 07.12.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 11.2 dhe 27 paragrafët 1.7 dhe 1.11 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas Konkursit letrar për poezi, ese dhe tregim të shkurtër, nr. prot. 09-016/01-0072879/23, datë 04.10.2023, dhe në rekomandim të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit me nr. prot. 02-016/01-0084871/23, datë 30.11.2023, merr:

V E N D I M LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Lejohen mjetet financiare për përfituesit sipas Konkursit letrar për poezi, ese dhe tregim të shkurtër për takimet e kulturës “ Kadri Kadriu” 2023 , në shumë 1750 €.

Neni 2

Ndarja e mjeteve financiare bëhet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë përfituesve.

Neni 3


Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-00103-0086709123
Podujevë, datë 17.12.2023

Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 14, 61 paragrafët 1.2) 1.7) të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

AUTORIZIM

I.

Autorizohet z. Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në Komunën e Podujevës, të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës.

Autorizimi për të përmendurin jepet për shkak të udhëtimit dhe qëndrimit zyrtar të Kryetarit të Komunës jashtë vendit, si dhe në mungesë të Nënkryetares së Komunës e cila është në pushim të lehonisë.

Autorizimi vlen nga data 18.12.2023 deri në kthimin e Kryetarit nga udhëtimi zyrtar.

II.

Nënshkrimi i dokumentacionit sipas pikës I bëhet në koordinim dhe konsultim paraprak me Kryetarin e Komunës.

Nga një kopje e Autorizimit u dërgohet:

- Të autorizuarit
- QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-016/01-0087630/23
Podujevë, datë: 14.02.2023

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 1 dhe 3.1 të Rregullores komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.por.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.06-400/04-0083333/23 të datës 21.11.2023, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z. Ekrem Agushi, nga fshati Shajkoc-Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomiko-sociale, në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve për trajtim mjekësor të fëmiut të tij Denis Agushi, i cili është në gjendje të rëndë shëndetësore, i jepet ndihmë financiare në shumë 1,000 €.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e Ekrem Agushit.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit e kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF.
QSHQ/Arkivit.
z.Ekrem Agushi (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.Prot. 02-400/04-008766 1/23
Podujevë, datë, 14.12.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 1 dhe 3.1 të Rregullores komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.por.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.06-400/04-0087580/23 të datës 14.12.2023, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z. Robert Gashi, me nr. personal të letërnjoftimit [redacted], për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe ekonomiko-sociale, në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve për trajtim mjekësor, i jepet ndihmë financiare në shumë 1,000 €.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e znj. Afërdita Gashi, e ëma e Robert Gashit.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit e kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF.

QSHQ/Arkivit.

znj.Afërdita Gashi (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.Prot. 02-400/04-0087788/23
Podujevë, datë, 15.02.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1, paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0085684/23, të datës 18.12.2023, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Leonorë Pollomi nga fshati Balloc, Komuna e Podujevës, për trajtimin mjekësor të bijës së saj Hana Pollomi, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 1000€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.
QSHQ/Arkivit.
znj.Leonorë Pollomi (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/04-0088287/23
Podujevë, datë, 18.12.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës merr,

VENDIM PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ORGANIZATIV PËR SHËNIMIN E 25 VJETORIT TË BETEJËS SË LLAPASHTICËS

Neni 1

Për shënimin e 25 vjetorit të Betejës së Llapashticës, që do të organizohet më 24 dhjetor 2023, ngritët Këshilli Organizativ, në këtë përbërje:

- | | |
|--|----------|
| 1. Pajtim Balaj , Drejtor i Drejtorisë së Kulturës rinisë dhe Sportit, | kryesues |
| 2. Edona Çitaku , Shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës, | anëtare |
| 3. Fatri Zhitija , Zëdhënës i Komunës, | anëtar |
| 4. Arbër Sfishta , zyrtar në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, | anëtar |
| 5. Florim Statovci , përfaqësues i Organizatës së Veteranëve të Luftës, | anëtar |

Neni 2

Këshilli merret me organizimin dhe përgatitjet e aktiviteteve dhe programeve për shënimin e 25 vjetorit të Betejës së Llapashticës, që do të mbahet më 24 dhjetor 2023.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
Anëtarëve të Këshillit
QSHQ / Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0088462/23
Podujevë, datë, 19.12.2023



Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, dhe komfor Ftesës Publike nr.prot. 15-300/01-0087477/23 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik- DPZHE, të publikuar me 14.12.2023 nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e shtëpizave të drurit sipas Ftesës Publike të DPZHE, për projektin “**Ditët e Fund Vitit 2023**” që ka për qëllim rritjen e aktiviteteve argëtuese dhe promovuese me rastin e festave të fund vitit dhe fluksit të ardhjes së mërgimtarëve, ku do të ofrohen shërbime të gastronomisë në “**Sheshin e Dëshmorëve**” në Podujevë, ngritet komisioni në përbërje:

1. Emine Muçolli Tahiri, kryesuese
2. Shkurte Musa, anëtare
3. Rilind Babatinca, anëtar

Neni 2

Komisioni bën shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve si dhe përzgjedhjen e aplikantëve/ bizneseve që do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në shtëpizat e drurit në “**Sheshin e Dëshmorëve**” sipas projektit të publikuar me Ftesën Publike.

Neni 3

Komisioni për punën e kryer, në formë të shkruar e informon Kryetarin e Komunës, përmes Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

QSHQ/Arkivit

Nr.prot 02-020/04-0089544/23
Podujevë, datë, 19.12.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në Rekomandim nr.prot 02-052/09-0086757/23 të datës 11.12.2023 të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik klubeve dhe shoqatave sportive në Komunën e Podujevës për organizimin e aktiviteteve sportive në Komunën e Podujevës, sipas Thirrjes publike për organizimin e aktiviteteve sportive, datë 06.10.2023, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE KLUBET DHE SHOQATA SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të Klubeve dhe Shoqatave sportive për realizimin e aktiviteteve sportive, sipas Thirrjes publike dt. 06.10.2023, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **11,000.00 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve sportive dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-052/09-0086757/23
Podujevë, dt. 21.12.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, nenin 16 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me Ligjin nr. 04/l-022 për përdorim civil të eksplozivëve, nxjerr:

URDHËRESË PËR NDALIMIN E PËRDORIMIT TË MJETEVE PIROTEKNIKE

I

NDALOHET përdorimi i mjeteve piroteknike/eksplzivëve në sheshe, rrugë, tregje dhe hapësira tjera publike në territorin e Komunës së Podujevës.

II

Ndalesa sipas pikës I të kësaj urdhërese vlen për periudhën 26 dhjetor 2023 deri më 03 janar 2024.

III

Personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese do të gjobiten në përputhje me rregullativën ligjore në fuqi.

IV

Për zbatimin e kësaj urdhërese kujdeset Drejtoria e Inspektionit.

V

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:
Drejtorisë së Inspektionit
Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-016/01-0099914123
Podujevë, datë: 26.12.2023



Kryetari i Komunës
Sipejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronjat e) f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Vendimit nr.08/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, neneve 16, 19 paragrafët 1.5; 1.6 dhe nenit 61 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 të Vendimit nr.prot.01-016/01-0079532/23 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi”, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 31 tetor 2023, merr,

VENDIM

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE “EKO-LLAPI” SH.A. NË PODUJEVË

Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. në Podujevë, emërohet,

z.Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.prot.01-016/01-0079532/23 të datës 31 tetor 2023.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;
Të emëruarit
Anëtarëve të Komisionit
Arkives

Nr.Prot. 02020/04-0091620/23
Podujevë, datë: 29.12.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58.b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 si dhe nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR REGJISTRIMIN E ARKËS TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN FISKAL 2023

Neni 1

Për regjistrimin e arkës të Komunës së Podujevës për vitin fiskal 2023, ngritet komisioni në përbërje:

Ardonis Jusufi kryesues
Alban Shabani anëtar
Jehona Murati anëtare

Neni 2

Komisioni më 29.12.2023 bën regjistrimin e arkës dhe Zyrës së Kryetarit të Komunës përmes drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i paraqet raport në formë të shkruar.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi u dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-02964-0091019/23
Podujevë, datë: 29.12.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 53 paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, në deklaram sipas kërkesës elektronike të datës 28.12.2023 të z. Fatlum Osmanit me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit, merr:

V E N D I M

Neni 1

Shfuqizohet Vendimi me nr. prot.02-020/04-0083474/23, datë 22.11.2023, sipas të cilit z. Fatlum Osmani Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave është emëruar anëtar në Komisionin komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Llapi" Sh. A. në Podujevë.

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit të cekur bëhet për shkak të paraqitjes së dorëheqjes së të përmendurit nga Komisioni në fjalë, për të shmangur konfliktin e interesit në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Ndërmarrjes sipas konkursit publik.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02020/04-0090870/23
Podujevë, datë: 29.12.2023

